

VENDIM
Nr. 108, datë 4.2.2015

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR
KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E
RIKONSTRUKSIONIT TË GODINËS SË RE TË KQZ-SË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 160, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, t’i shtohet fondi prej 57 937 000 (pesëdhjetë e shtatë milionë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të rikonstruksionit të godinës së re të KQZ-së.

2. Fondi prej 57 937 000 (pesëdhjetë e shtatë milionë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë) lekësh do të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2015.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama